



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Zyra e Rregullatorit për Energji shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Analist për përmbushje të standardeve
Klasa e pozitës	Profesional 2
Koeficienti/Paga	890/Fix
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	16/09/2022
Afati për aplikim	01/10/2022 - 10/10/2022
Institucioni	Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti	Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve
Divizioni	
Vendi i punës	Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve
Nr. i Referencës	RN00009878
Kodi	RPC0003599



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

Analisti/ja për Përbushje të Standardeve i raporton Udhëheqësit të Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorëve. Është përgjegjës për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorëve në ZRRE. Do t'i ndihmojë udhëheqësit të Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorëve të ZRRE-së në përgatitjen dhe implementimin e Përbushjes së Standardeve që janë të ndërlidhura me vazhdueshmërinë, efikasitetin dhe sigurinë e furnizimit të energjisë . Përveç kësaj ai/ajo do të monitorojë të licencuarit në lidhje me përbushjen e standardeve dhe këshillojë mbikëqyrësin në çështjet që kanë të bëjnë me performancën në rast të çfarëdo kontesti ndërmjet konsumatorëve.

Analisti/ja për Përbushje të Standardeve ofron asistencë të përgjithshme Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorëve, dhe nëse kërkohet edhe stafit të ZRRE-së. Ai/ajo do të analizojë ankesat/kërkesat e konsumatorëve si dhe ofron asistencë po ashtu në hartimin e përgjigjeve në padi, ankesave, përgjigjeve në ankesa, dhe përfaqësimin e ZRRE në gjykatë, në konfliktet administrative të iniciuara nga konsumatorët dhe të licencuarit si dhe hartimin e parashtrësive tjera sipas nevojës

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për levizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Diplomën universitare në juridik;
- Eksperiencë praktike në sektorin e energjisë elektrike, do të ishte përparësi puna në shërbimin për konsumatorë;
- Së paku 3 vite përvojë punë në sektor të energjisë;
- Njohuria me punën e Rregullatorit të Energjisë do të jetë një përparësi;
- Njohuri të punës me programet Microsoft Office;
- Njohja e shkëlqyer e njëres gjuhë zyrtare është obligative dhe njohja e gjuhës së dytë zyrtare është e dëshirueshme;
- Njohja e mirë gjuhës angleze do të jetë përparësi
- Aftësi për të punuar në ambient multi-etnik dhe multi-kulturor;
- Aftësi për të punuar në një nivel të lartë të besueshmërisë;



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

Monitorimin dhe Analizimin e Përbushjes së Standardeve

- Menaxhon sistemin raportues të shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë sa i përket vazhdueshmërisë dhe kualitetit.
- Ndhmon në zhvillimin dhe implementimin e sistemit të masave për përbushje të kërkesave të konsumatorëve
- Propozon dhe ndihmon në implementimin e Standardeve të Përbushjes dhe masave sa i përket vazhdueshmërisë së furnizimit me përqendrim të veçantë në:
 - Kohëzgjatjen e ndërprerjeve
 - Numrin e ndërprerjeve
 - Karakteristikat e voltazhës/tensionit
- Harton përgjigje ne padi, ankesa, përgjigje në ankesa dhe parashtresa tjera për gjykata për rastet e ankesave te konsumatorëve;
- Përfaqëson ZRRE pranë gjykatës kompetente në konfliktet administrative të iniciuara nga konsumatorët dhe të licencuarit, ndaj vendimeve për ankesat e konsumatorëve;
- Harton draft vendimet e shkallës së dytë për ankesat e konsumatorëve;
- Merr pjesë në ndërtimin e konceptit, themelimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për ankesat e konsumatorëve dhe lendeve gjyqësore, duke përfshirë informatat e nevojshme dhe raportet.

Ndihma Administrative

- Ofron ndihmë të përgjithshme administrative për Departamentin për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRRE;
- Ndhmon në takime me konsumatorët dhe aksionarët, dhe merr shënime gjatë takimeve;
- Organizon dhe mban kontakte të rregullta me grupet e themeluara të konsumatorëve;
- Mirëmban dhe freskon sistemin arkivues;
- Mirëmban dhe freskon sistemin e lendeve gjyqësore per ankesat e konsumatorëve;
- Ndhmon në procedimin e korrespondencës hyrëse dhe dalëse dhe mban shënimet për korrespondencë;
- Arkivon, fotokopjon, dhe shpërndanë dokumente;

Detyrat e tjera

- Ndhmon mbikëqyrësin e tij/saj në zgjedhjen e procedurave kontestuese duke i analizuar raportet e të licencuarve dhe ankesat e konsumatorëve
- Përkrah departamentet e tjera të ZRRE-së ashtu siç i kërkohet
- Bashkëpunon me ekspertët e grupeve të industrive të ndryshme në energji dhe ndërmarrjet e energjisë
 - Detyra të tjera ashtu siç i kërkohet nga mbikëqyrësi i tij/saj ose Drejtori menaxhues i ZRRE-së.



5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 17/10/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- 01/11/2022; ora 10:00; ZRRE salla e takimeve

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Njohuri me punën në sektor të energjisë;
- Njohuri me punën e Rregullatorit të Energjisë do të jetë një përparësi;
- Njohuri të punës me programet Microsoft Office;
- Njohja e shkëlqyer e njërës gjuhë zyrtare është obligative dhe njohja e gjuhës së dytë zyrtare është e dëshirueshme;
- Njohja e mirë gjuhës angleze do të jetë përparësi;

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.



Të dhëna shtesë:

Gjatë kryerjes së detyrave të punës, ky vend i punës i ekspozohet kushteve normale të punës. Ka kontakte të drejtpërdrejta me palët e interesit dhe mund të ketë kontakte edhe me konsumatorë gjatë trajtimit të ankesave dhe pakënaqësive që kanë.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

